

## Numrat emergjent

Numrat emergjent janë çdo ditë 24 orë hapur. Numrat e shkurt (3 shifra) janë çdo herë falas. Për numrat e tjerë paguan njeriu sipas rregullit tarifen normale për telefon.

### **Numrat e përgjithshëm emergjent: 112**

Me këtë numër e arrin njeriu qendren emergjente të policisë. Sipas llojit të emergjencës informon policia edhe vendet tjera si (p.sh. zjarrëfikësit).

### **Policia: 117**

Me këtë numër e arrin njeriu qendren për thirrje emergjente në polici.

### **Zjarrëfikësit: 118**

Me këtë numër e arrin njeriu qendren e veprimit të zjarrëfiksëve

### **Ndihma e parë / shërbimi i shpëtimit: 144**

Me këtë numër arrin njeriu qendren e veprimit të shërbimit të shpëtimit. Numri 144 duhet të thirret vetëm kur njeriu i nevojitet menjëherë ndihmë dhe nevojitet transport me ndihmë të shpejt ose kur njeriu nuk din ta vlerësoj situatën (p.sh) pas një aksidenti). Te problemet e tjera medicinale njeriu e kontakton s`pari një mjek familjar / një mjek familjare. Jashtë orarit të punës kanë disa mjek familjar shërbim për emergjenca. Kush ka shërbim në emergjencë, e kupton njeriu në mes mesazhit në telefon të mjekut familjar apo në shtypin rajonal. Në situata jo-kërcënuese për jetën, mund të telefononi edhe Qendrën e Thirrjeve të Urgjencës Mjekësore (MNZ) në 061 261 15 15. Aty merr njeriu këshilla mjekësore dhe drejtohet në vendin e duhur (mjek, spital). është e mundshme, vetë të kërkoni një stacion emergjent (Spital/ emergjencë).

### **Farmaci emergjente: 061 263 75 75**

Me këtë numër mëson njeriu, cilat barnatore në Basel-Landschaft dhe Basel-Stadt janë hapur për shërbime emergjente (Notfallapotheke). Aty mundet njeriu edhe jashtë orarit të rregullt të punës të marr medikamente.

### **Mjeku i dhëmbëve për shërbime emergjente:061 261 15 15**

Me këtë numër mëson njeriu, cili mjek i dhëmbëve apo mjek e dhëmbëve ka shërbim emergjent në kantonin Basel-Landschaft.

### **Thirrja emergjente-helmimi:145**

Nëse njeriu gëlltit diçka helmuese apo supozon që ka gëlltit diçka helmuese, ju ndihmojnë mjekët dhe specialistët në këtë numër. Ata sqarojnë çka duhet të bëni te helmimi. Te gjendja e rrezikshme për jetë duhet njeriu menjëherë ta thërras numrin 144. Në faqen e internetit gjeni informacione të shumta për temën helmi/helmimi.

### **Këshillimi të rriturr: 143**

"Telefoni 143" (Dora e Zgjatur, Dargebotenehand) është për persona të cilët dëshirojnë të flasin për problemet e tyre pa marrë parasysh për llojin e problemit (në gjermanisht, frëngjisht, italisht). Njeriu mund të thërras edhe në situata krizash mirëpo edhe te të gjitha vështësitë dhe brengat tjera. Biseda është në besim dhe anonime. Sipas dëshirës merr njeriu informacione edhe për oferta të tjera që ofrojnë ndihmë të përshtatshme.

### **Këshillimi për fëmijë / të rinjë: 147**

"Telefoni 147" është për fëmijë dhe të rinjë, të cilët dëshirojnë me dikë të flasin për problemet e tyre të çfarë do lloji qofshin (në gjermanisht, frëngjisht, italisht). Njeriu mundet të thërras në situata krize, mirëpo edhe te të gjitha vështësitë e tjera. Një person i specializuar është 24 orë në dispozicion. Biseda është në besim dhe anonime. Kontakti është i mundshëm edhe me Mail, SMS; apo Chat.

### **Thirrja emergjente për prindër: 0848 35 45 55**

Thirrja emergjente për prindër (Elternnotruf) këshillojnë specialistët prindërit apo personat e tjerë në lidhje me pyetjet për edukim. Ata ndihmojnë, kur njeriu është i brengosur apo i mbingarkuar për fëmijun e tij apo një fëmijë tjetër. Njeriu mundet me u drejtue edhe në thirrjen emergjente për prindër, kur njeriu frikohet, që fëmiju i tij apo një tjetër është viktim i keqtrajtuar psikikisht/fizikisht. Biseda është në besim dhe sipas dëshirës anonime. Kontakti me Mail është i mundshëm. Te pyetjet medicinale kjo thirrje nuk mundet të ndihmojë.

### **Dhuna shtëpiake (gratë): 061 681 66 33**

Shtëpia e grave (Frauenhaus) beider Basel ofron përgjatë 24 orëve këshilla dhe mbështetje grave të cilat janë të prekura nga dhuna shtëpiake. Edhe të afërmit dhe njerëzit specialist mundën me u drejtue te kjo shtëpi. Biseda është në besim dhe sipas dëshirës anonime. Informacione të hollësishme për temën dhuna shtëpiake, edhe për burrat e prekur dhe datat për kontakt për ecurin e mëtejme dhe këshillimet i gjeni në kapitulin Marrëdhënie partnerësh dhe Dhuna në familje nën hallo-baselland.ch.

### **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-baselland.ch/sq/emergjencat-dhe-keshillimoret/numrat-emergjent](http://www.hallo-baselland.ch/sq/emergjencat-dhe-keshillimoret/numrat-emergjent)